

MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SPORTIT
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

Fusha “Gjuhët dhe komunikimi”

Programi i lëndës

“GJUHA E HUAJ E PARË”

Klasa X



JANAR 2016

HYRJE

Gjuha e huaj (anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht etj.) bën pjesë në fushën “Gjuhët dhe komunikimi”. Kjo fushë synon zhvillimin gjuhësor dhe letrar i cili është boshti themelor për rritjen intelektuale, sociale dhe emocionale të nxënësve. Më konkretisht, fusha “Gjuhët dhe komunikimi” i aftëson nxënësit në përdorimin e gjuhës për të komunikuar, për të përmbushur interesat e tyre personale dhe shoqërore, si dhe për të plotësuar kërkesat e shoqërisë dhe të vendit të punës.

Mësimi i gjuhës amtare, i letërsisë dhe i gjuhëve të huaja i ndihmon nxënësit që të bëhen individë të pavarur, të lirë, të kulturuar, mendimtarë kritikë dhe krijues, si dhe njerëz të vetëdijshëm për identitetin e tyre personal dhe kombëtar. Me anë të leximit të teksteve të letërsisë shqipe dhe asaj botërore (në gjuhën shqipe ose në një gjuhë të huaj), nxënësit zhvillojnë botën e tyre emocionale, pasurojnë përfytyrimet dhe imagjinatën e tyre për botën, çmojnë dhe vlerësojnë gjuhët dhe kulturën kombëtare e botërore.

Fusha “Gjuhët dhe komunikimi” nxit dëshirën, kuriozitetin dhe besimin e nxënësve për t’u bërë komunikues të mirë, lexues aktivë e të pavarur dhe shkruar të saktë, origjinal dhe krijues. Duke patur një rëndësi të tillë, fusha dhe lëndët që e përbëjnë atë, synojnë të përmbushin pesë kompetencat: të dëgjuarit; të folurit; të lexuarit; të shkruarit; përdorimi i drejtë i gjuhës.

Kjo fushë përbëhet nga lëndët: Gjuhë shqipe, Letërsi, Gjuhë e huaj e parë, Gjuhë e huaj e dytë.

Gjuha shqipe mësohet në të gjitha shkallët e kurrikulës, nga klasa përgatitore deri në klasën XII.

Gjuha e huaj e parë fillon në shkallën e dytë (klasa III) dhe mësohet deri në shkallën e gjashtë (klasa XII).

Gjuha e huaj e dytë fillon të mësohet në shkallën e tretë (klasa VI) dhe vazhdon deri në shkallën e gjashtë (klasa XII). Si gjuhë e huaj e dytë mund të jetë: gjuha frënge, gjuha italiane, gjuha gjermane etj.

Programi i gjuhës së huaj ka në fokus realizimin e kompetencave kyçe dhe të kompetencave të fushës (janë të përbashkëta për të gjitha lëndët e fushës “Gjuhët dhe komunikimi”). Gjatë punës për përmbushjen e kompetencave kyçe dhe kompetencave të fushës, nëpërmjet gjuhës së huaj do të realizohen temat ndërkurrikulare, të cilat mundësojnë lidhjen e lëndës me jetën e përditshme, shoqërinë dhe tregun e punës.

Në program, gjithashtu, përshkruhet lidhja e gjuhës së huaj me fushat e tjera, në mënyrë që formimi i nxënësit të mos jetë fragmentar, por tërësor.

Në program janë përcaktuar njohuritë, aftësitë, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet për çdo kompetencë të fushës. Këto njohuri, aftësi, shkathtësi, vlera dhe qëndrime janë klasifikuar sipas disa tematikave.

Kompetencat përcaktohen si njohuri, shkathtësi, vlera dhe qëndrime që një nxënës duhet t'i fitojë gjatë procesit mësimor.

- **Njohuri** është:

- a) një e vërtetë e arsyetuar dhe e provuar sipas kriterëve të përcaktuara, e kodifikuar në tekstet akademike e ato shkollore apo në vepra të specializuara si produkt i një ose disa dijetarëve apo praktikienëve.
- b) ndërtim mendor i realizuar nga personi gjatë bashkëveprimit me mjedisin ose nga vetëreflektimi për t'u bërë pjesë e trashëgimisë njohëse të tij, si p.sh., njohuri për llojet e teksteve, njohuri gramatikore, njohuri për hartimin e një prezantimi etj.

- **Shkathtësi** është një kapacitet (mendor/fizik) i fituar për të arritur rezultatet e parashikuara, shpesh me shpenzim minimal të kohës ose energjisë, ose të të dyjave bashkë. Shkathtësia mund të jetë e përgjithshme ose e veçantë, si: të kuptuarit, të interpretuarit, të menduarit në mënyrë kritike dhe krijuese, zgjidhja e problemeve etj.

- **Qëndrimet** janë një mënyrë e përcaktuar e të menduarit, opinionëve dhe ndjenjave ndaj diçkaje, një ideje, personi ose situatë dhe që ndikojnë në sjelljen e individit.. Qëndrimet ndikohen nga njohuritë dhe vlerat dhe janë zakonisht shkaktare të sjelljeve (edhe pse lidhjet mes qëndrimeve dhe sjelljeve nuk janë drejtvizore). **Vlerat** janë bindje që ruhen thellë lidhur me çfarë është e rëndësishme ose e dëshirueshme. Ajo shprehet nëpërmjet qëndrimeve dhe veprimeve praktike të personave. Disa vlera dhe qëndrime janë respektimi i rregullave të etikës gjatë të folurit, shmangia e fyerjeve dhe paragjykimëve, si dhe formave e tjera denigruese të gjuhës, shpirti i iniciativës, serioziteti, vetëbesimi etj.

Puna për ndërtimin e kompetencave kyçe dhe të lëndës ka nisur që në arsimin bazë. Në këtë nivel arsimit nxënësit janë pajisur me njohuritë, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet e domosdoshme për jetën dhe për tregun e punës. Mirëpo kompetenca zhvillohet vazhdimisht, nuk ka pikëmbërritje (zhvillohet gjatë gjithë jetës). Kur fillojnë arsimin e mesëm, nxënësit kanë para tyre sfida të reja. P.sh., nga kontekste familjare dhe

informale (me shokët e shoqet e klasës dhe me mësuesit), nxënësit tani do të flasin në kontekste më formale (në një debat në shkollë, në aktivitete me mësues).

I. KORNIZA KONCEPTUALE E PROGRAMIT TË GJUHËS SË HUAJ

Hartimi i programit lëndor mbështetet në dokumentet kryesore kurrikulare: korniza kurrikulare, kurrikula bërthamë dhe plani mësimor i arsimit të mesëm të lartë. Ky program shoqërohet me udhëzues dhe dokumente të tjera në ndihmë të mësuesve dhe hartuesve të teksteve mësimore.

Përdoruesit e programit janë mësuesit, autorët e teksteve, prindërit dhe komuniteti, specialistët e arsimit dhe fakultetet e mësuesisë.

Mësuesit do ta përdorin programin e gjuhës së huaj për të krijuar një tablo të qartë rreth asaj se çfarë duhet të nxënë nxënësit dhe se si duhet të ndërtojnë mësimdhënien për të pajisur nxënësit me kompetencat kyçe dhe të lëndës, si dhe për të përmbushur kërkesat e programit.

Autorët e teksteve do ta përdorin programin e gjuhës së huaj për të hartuar tekste që janë në funksion të realizimit të tij. Leximi i kujdesshëm i programit për çdo shkallë dhe klasë do t'i ndihmojë për të siguruar koherencën dhe për të shmangur ngarkesën e panevojshme.

Prindërit dhe komuniteti nëpërmjet programit mund të informohen për kompetencat që duhet të zotërojnë fëmijët e tyre në lëndën e gjuhës së huaj.

Specialistët e arsimit mund ta përdorin programin e gjuhës së huaj për qëllime inspektimi, monitorimi, vlerësimi, studimi etj.


Fakultetet e mësuesisë mund ta përdorin programin lëndor për të përshtatur kurrikulat e tyre, me qëllim përgatitjen efektive të mësuesve të ardhshëm, si dhe për praktikën pedagogjike të studentëve.

Programi i gjuhës së huaj ka në fokus realizimin e kompetencave kyçe dhe të kompetencave të lëndës. Gjatë punës për përmbushjen e kompetencave kyçe dhe të kompetencave të lëndës, do të realizohen temat ndërkurrikulare të cilat mundësojnë lidhjen e lëndës me jetën e përditshme, shoqërinë dhe tregun e punës.

Në program, gjithashtu, përshkruhet lidhja e gjuhës së huaj me fushat dhe lëndët e tjera, në mënyrë që formimi i nxënësit të mos jetë fragmentar, por tërësor.

Në program janë përcaktuar njohuritë, aftësitë, shkathhtësitë, vlerat dhe qëndrimet për çdo kompetencë të lëndës. Këto njohuri, aftësi, shkathhtësi, vlera dhe qëndrime janë klasifikuar sipas disa tematikave. Po kështu, në program janë sugjeruar edhe orët mësimore për çdo kompetencë.

Diagrami i mëposhtëm paraqet organizimin e programit.



1. Qëllimet e arsimit parauniversitar

Arsimi parauniversitar krijon kushte dhe mundësi që nxënësit: të ndërtojnë dhe të zhvillojnë njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera që kërkon shoqëria demokratike; të zhvillohen në mënyrë të pavarur e të gjithanshme; të kontribuojnë në ndërtimin dhe mirëqenien vetjake dhe të shoqërisë shqiptare, si dhe të përballen në mënyrë konstruktive me sfidat e jetës.

Në arsimin parauniversitar nxënësit:

- kultivojnë identitetin vetjak, kombëtar dhe përkatësinë kulturore;
- përvetësojnë vlera të përgjithshme kulturore dhe qytetare;
- zhvillohen në aspektet intelektuale, etike, fizike, sociale dhe estetike;
- zhvillojnë përgjegjësi ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit;
- aftësohen për jetë dhe për punë, në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore;
- aftësohen për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- zhvillojnë shpirtin e sipërmarrjes;
- përdorin teknologjitë e reja.

2. Qëllimet e programit të lëndës “Gjuha e huaj”

Programi mësimor i gjuhës së huaj për klasën X është hartuar në përputhje me Kurrikulën Kombëtare të Gjuhëve Moderne për Arsimin Publik Parauniversitar, si dhe në përputhje me Kuadrin e Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët, me qëllim që t’i përgjigjet një shoqërie të hapur sipas kërkesave dhe nevojave që shtrohen përpara mësimin dhe përvetësimit të gjuhës së huaj në vendin tonë.

Lënda e gjuhës së huaj ka për mision aftësimin dhe orientimin e nxënësve për të vepruar në situata të ndryshme komunikimi në këtë gjuhë. Ajo ka për detyrë të zhvillojë te nxënësit aftësitë e gjuhës gjatë përdorimit të saj dhe t’i edukojë ata me të kuptuarit, pranimin dhe vlerësimin e kulturës dhe mënyrës së jetesës së popujve të tjerë. Nxënësit, gjithashtu, mësojnë dhe binden që gjuha e huaj, si një subjekt aftësish dhe mjet

komunikimi, kërkon kohë dhe praktika të shumëllojshme komunikimi për t'u përvetësuar. Si lëndë akademike, gjuha e huaj është një lëndë kulture dhe aftësish.

Mësimi i gjuhës së huaj, në klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë, zhvillohet në **nivelin B1+**, duke iu referuar *Kuadrit të Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët*.

Në këtë fazë të formimit, synimi i gjuhës së huaj është të pasurojë aftësitë e fituara në nivelet e mëparshme, në mënyrë që nxënësi të arrijë të konsolidojë nivelin **B1** dhe të kalojë në **nivelin B1+**, i cili i korrespondon një niveli më të lartë se **Niveli B1**, (niveli prag). Në këtë nivel shtohen një numër përshkruesish që përqendrohen në sasinë e informacionit të shkëmbyer, me qëllim që nxënësi të aftësohet gjithnjë e më shumë si një përdorues i pavarur i gjuhës.

Lënda e gjuhës së huaj në arsimin e mesëm të lartë ka si qëllim që nxënësi:

- të ndërgjegjësohet për aspektet kulturore dhe të reflektojë mbi ndryshimet mes praktikave kulturore të vendit ku flitet gjuha e huaj dhe kulturës amtare;
- të zhvillojë më tej aftësinë komunikuese dhe përdorimin e njohurive gjuhësore në situata praktike të jetës së përditshme;
- të forcojë ndërveprimin në situata reale dhe jashtëshkollore, lidhur me tematikën e trajtuar në situatat mësimore;
- të konsolidojë bashkëveprimin ndërmjet punës në grup dhe punës së pavarur individuale dhe krijuese;
- të thellojë njohuritë gjuhësore, perceptuese dhe shprehëse, përmes të cilave ai zgjeron njohuritë për botën dhe, në të njëjtën kohë, formohet intelektualisht.

Interesat dhe tematikat në këtë program do të jenë të ndryshme (*jeta personale e shoqërore, jeta në shkollë e në punë, bota rreth nesh, bota e komunikimit etj.*), pasi shkalla e ndërgjegjësimit të nxënësit për domosdoshmërinë e mësimin të gjuhës së huaj është më e lartë dhe mësimi i gjuhëve të huaja lidhet me problemet e formimit të tij si qytetar evropian. Zotërimi i mirë i gjuhës së huaj ndihmon në zgjerimin e dijeve në fusha të tjera. Përvetësimi i gjuhës së huaj kontribuon jo vetëm në pasurimin dhe në lulëzimin e individualitetit të nxënësit, por edhe në ndërtimin e qëndrimeve dhe të sjelljeve etike që i shërbejnë komunitetit dhe krijimit të një qytetari të ri evropian.


3. Lidhja e kompetencave kyçe me kompetencat e fushës

Realizimi i kompetencave kyçe të kornizës kurrikulare gjatë procesit të mësimdhënies dhe nxënies kërkon që mësuesi të lidhë kompetencat kyçe me kompetencat e fushës për secilën shkallë. Për të realizuar në praktikë këtë lidhje, mësuesi duhet të përzgjedhë metodat, teknikat dhe mjetet e përshtatshme didaktike për realizimin e çdo kompetence dhe rezultati të të nxënit. Kur nxënësi përmbush kompetencat gjuhësore, ai njëkohësisht është duke zhvilluar edhe kompetencat kyçe. P.sh., gjatë prezantimeve të ndryshme në orët mësimore të kompetencës së të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar, nxënësi përdor edhe mjetet e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit dhe realizon kështu edhe kompetencën digjitale. Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës ku bën pjesë lënda e gjuhës së huaj, pasqyrojnë të njëjtën qasje me rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe në këndvështrimin e domosdoshmërisë së tyre në jetë, shoqëri dhe punë.

Më konkretisht, për të realizuar lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e fushës mësuesi ndjek këto hapa:

- përzgjedh rezultatin/et e të nxënit për kompetencat kyçe që synon të arrijë nxënësi në shkallën përkatëse;
- zbërthen në rezultate të nxëni për kompetenca kyçe për secilin vit mësimor rezultatin/et e të nxënit për shkallë, për kompetencat kyçe;
- përzgjedh përmbajtjen/et mësimore, mjetet didaktike, metodologjinë e mësimdhënies, përmes të cilave realizon rezultatet e të nxënit;
- planifikon mësimdhënien duke përfshirë periudhën kohore gjatë së cilës do t'i arrijë rezultatet e të nxënit brenda vitit shkollor;
- kryen analiza dhe vlerësime të ecurisë së nxënësve pas realizimit të orëve mësimore, detyrave, projekteve, për të verifikuar arritjet e rezultateve të të nxënit për vit mësimor dhe shkallë për fushën “Gjuhët dhe komunikimi”.

Diagrami i mëposhtëm konkretizon lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e fushës.



Rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së gjuhës së huaj në klasën e dhjetë.

Në kurrikulën bërthamë janë përcaktuar rezultatet e të nxënit për çdo kompetencë kyçe. Këto rezultate realizohen nëpërmjet fushave të të nxënit. Natyrisht, secila fushë dhe lëndë mund të kontribuojë në disa rezultate të nxëni. Fusha “Gjuhët dhe komunikimi” ndihmon realizimin e të gjitha kompetencave, por më së shumti në kompetencën e komunikimit dhe të të shprehurit. Tabela e mëposhtme paraqet rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së gjuhës së huaj në klasën e dhjetë.

KLASA X

Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit

Nxënësi:

1. merr pjesë në bashkëbisedime me moshatarët dhe të rriturit për tema me interes mësimor dhe shoqëror duke bërë pyetje, duke dhënë përgjigje dhe duke veçuar informacionin kryesor;
2. transmeton saktë të dhënat e mbledhura për një temë konkrete në formë tekstuale, numerike, verbale, elektronike apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit;
3. prezanton para të tjerëve një projekt për një temë të dhënë, të përgatitur vetë ose në grup, duke gërshetuar format e komunikimit verbal dhe elektronik, si dhe veprimin praktik;
4. përshkruan me gojë dhe me shkrim një ngjarje të lexuar ose të dëgjuar duke ruajtur rrjedhën logjike të saj;
5. analizon përmbajtjen dhe kuptimin e nocioneve (koncepteve) të reja, duke përdorur leksikun e përshtatshëm;
6. identifikon burime të ndryshme informacioni për arsimim dhe orientim profesional, si dhe zhvillon një plan individual për zhvillimin e karrierës së tij.

Kompetenca e të menduarit

Nxënësi:

1. përzgjedh dhe klasifikon informacionin nga burime të ndryshme në bazë të një kriteri të caktuar për një temë konkrete dhe e përdor për marrjen e një vendimi apo për zgjidhjen e një problemi/detyre;
2. analizon një punim (p.sh., artikull gazete, pikturë etj.) duke gjetur analogji dhe dallime me punime të ngjashme nga autorë të ndryshëm;
3. përpunon idenë e vet në një projekt me shkrim për një çështje të caktuar duke propozuar qëllimin, aktivitetet kryesore, afatet, vendin, personat, materialet dhe mjetet e nevojshme për kryerjen e tyre;
4. argumenton ndërmarrjen e hapave konkretë, të cilët çojnë në përfundimin e një detyre/aktiviteti, në zgjidhjen e një problemi, të ndonjë punimi në klasë/shkollë;
5. shprehet pro dhe kundër për një mendim, qëndrim, sjellje të manifestuar nga një apo më shumë persona (në klasë/shkollë apo jashtë saj).

Kompetenca e të nxënit

Nxënësi:

1. regjistron në formë të shkruar, grafike, etj., informacionin/faktet për një temë;
2. veçon me anë të teknikave të ndryshme pjesët sipas rëndësisë dhe nevojës për temën/detyrën e dhënë;
3. shfrytëzon në mënyrë efikase fjalorët, enciklopeditë dhe teknologjinë informative apo burime të tjera për zhvillimin e një ideje /projekti me bazë klase/shkolle ose jashtë saj;
4. regjistron, skedon dhe përdor teknika të tjera për të m e n a x h u a r informacionin/ faktet ose formulat për një temë duke i radhitur ato sipas llojit, burimit dhe rëndësisë;
5. paraqet/skicon idetë e veta për ecurinë dhe mënyrën e zhvillimit të një aktiviteti duke e argumentuar para të tjerëve;
6. prezanton në mënyrë të pavarur udhëzimet /simbolet e dhëna në libër, skicë, plan, partiturë muzikore, skenar, koreografi etj., për të përmbushur një veprim, aktivitet ose detyrë që kërkohet prej tij;
7. shfrytëzon në mënyrë të efektshme teknika të ndryshme gjatë të nxënit të temës së dhënë duke klasifikuar informacionin e njohur nga ai i

panjohur, si dhe atë që është i paqartë;

8. përdor elementet e portofolit personal për vetëvlerësimin dhe identifikimin e anëve të forta, i shfrytëzon ato për përparimin në mësim dhe për orientimin për karrierë.

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin

Nxënësi:

1. vlerëson rëndësinë e punës individuale dhe në grup për zhvillimin e komunitetit nëpërmjet shembujve konkretë nga jeta e përditshme;
2. përdor materiale, burime të ndryshme informimi dhe teknologjinë në shkollë dhe në jetën e përditshme si ndihmë për përparimin në mësim dhe për orientim në karrierë.
3. përgatit një plan pune për kryerjen e një detyre ose të një projekti;
4. vlerëson dhe kritikon mënyrën e sjelljes së nxënësve në klasë, në shkollë dhe mjedise të tjera në një situatë të caktuar;
5. identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në shtëpi;
6. përgatit një autobiografi ku prezanton veten, të dhënat personale dhe prirjet që ka për fusha të caktuara, si dhe profesionin e dëshiruar;
7. përgatit një plan pune një javor;
8. diskuton me një fjalor të thjeshtë për mënyrën e sjelljes së nxënësve në klasë, në shkollë dhe mjedise të tjera në një situatë të caktuar, duke prezantuar idetë nëpërmjet shembujve konkretë.

Kompetenca personale

Nxënësi:

1. bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitetet në klasë, shkollë apo jashtë saj;
2. bashkëpunon në mënyrë aktive me të gjithë moshatarët (pavarësisht prejardhjes së tyre, aftësive dhe nevojave të veçanta) drejt arritjes së një qëllimi të përbashkët. (projekti/ aktiviteti në bazë klase /shkolle apo jashtë saj);
3. analizon shkaqet e një reagimi konfliktual apo emocional dhe propozon alternativa për zgjidhje të drejtë e pa pasoja duke ndarë përvojat, mendimet dhe ndjenjat me anëtarët e grupit.

Kompetenca qytetare

Nxënësi:

1. shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive, vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët, për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar;
2. praktikon të drejtat dhe detyrimet si qytetar në situata konkrete të jetës së përditshme, në klasë, shkollë, komunitet ose gjatë diskutimit dhe respektimit të mendimit të tjetrit;
3. reagon ndaj personave të cilët shkelin, cenojnë ose mohojnë të drejtat e të tjerëve si dhe arsyeton pasojat e këtyre veprimeve për individin, grupin dhe komunitetin;
4. përgatit në grup një aktivitet, duke përdor tolerancën si mjet për promovimin e diversitetit kulturor, etnik, gjinor, fetar, social etj., në shkollë apo në komunitet.

Kompetenca digjitale

Nxënësi:

1. përdor TIK-un për të lehtësuar procesin e të nxënit dhe për të rritur efektivitetin në mësimdhënie;

2. përdor mjetet multimediale për të bashkëpunuar me persona të tjerë dhe për të rritur produktivitetin e tij dhe të nxënësve;
3. bashkëpunon me moshatarët e tij duke përdorur mjetet e telekomunikacionit bashkëpunues, për të trajtuar tema mësimore, për të zgjidhur çështje dhe probleme që mund të lindin në shkollë dhe jashtë saj.

4. Lidhja e gjuhës së huaj me temat ndërkurrikulare

Temat ndërkurrikulare janë tema madhore, me të cilat përballet shoqëria tani dhe në të ardhmen. Ato integrojnë fushat e të nxënësve të cilat i ndihmojnë nxënësit të interpretojnë botën dhe të lidhin dijet e marra në shkollë, me jetën dhe interesat e tyre. Në kornizën kurrikulare dhe në kurrikulat bërthamë janë përcaktuar temat ndërkurrikulare të cilat janë:

- Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave
- Të drejtat e njeriut
- Vendimmarrja morale
- Zhvillimi i qëndrueshëm
- Ndërvarësia
- Bashkëjetesa paqësore

Gjuha e huaj zhvillon te nxënësit njohjen e vlerësimit të kulturës botërore dhe kultivon identitetin dhe krenarinë kombëtare. Tema si: të drejtat e njeriut, vendimmarrja morale, mjedisi, zhvillimi i qëndrueshëm etj. mund të realizohen gjatë orëve mësimore të kompetencës së të folurit. Mësuesi mund të krijojë edhe situata mësimore gjatë të cilave nxënësit shprehin në forma të ndryshme: ese, poezi, tregime dhe krijime të tjera me tematikë çështjet e mësipërme. Punët në grupe dhe projektet që zhvillohen në lëndën e gjuhës së huaj, ndihmojnë në krijimin e aftësive të nxënësve për të jetuar në mënyrë paqësore me të tjerët.

5. Kompetencat e fushës

Fusha “Gjuhët dhe komunikimi” realizon pesë kompetenca të cilat janë: Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme; të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar; të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare; të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale; përdorimi i drejtë i gjuhës.

Përshkrimi i kompetencave të fushës

a) Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme

Nxënësit marrin njohuri, zhvillojnë qëndrime dhe vlera, si dhe zbatojnë aftësi dhe shkathtësi duke dëgjuar tekste të shkruara, të folura dhe mediatike.

Më konkretisht, nxënësit kuptojnë se sjellja dhe qëndrimet e duhura gjatë të dëgjuarit ndikojnë pozitivisht te të tjerët. Ata dallojnë disa cilësi të zërit të folësit si: intonacioni, ritmi, theksi, volumi i zërit. Gjithashtu, nxënësit ritregojnë, veçojnë idenë kryesore, dallojnë fjalët ose frazat kyçe, bëjnë konkluzione, krahasojnë ose klasifikojnë, si dhe bëjnë vlerësime të thjeshta për tekstet që dëgjojnë.

b) Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar

Nxënësit: përdorin drejt gjuhën standarde gjatë folurit; kuptojnë dhe zbatojnë në komunikim karakteristikat e gjuhës së folur; shqiptojnë saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët dhe fjalitë, me qëllim që të jenë të kuptueshëm dhe interesantë për të tjerët; shoqërojnë të folurin edhe me elemente të komunikimit jo verbal; diskutojnë dhe bashkëveprojnë me të tjerët gjatë punës në grup.

c) Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare

Nxënësit lexojnë tekste letrare dhe jo letrare që u përkasin periudhave të ndryshme, tekste klasike dhe bashkëkohore, shqipe dhe botërore dhe demonstrojnë kuptimin, interpretimin, analizën, vlerësimin dhe gjykimin e këtyre teksteve (të përshtatshme për zhvillimin moshor të nxënësve).

d) Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale

Nxënësit shkruajnë për qëllime personale dhe funksionale. Ata ndjekin gjatë të shkruarit hapa si: planifikimi, organizimi i ideve, rishikimi dhe redaktimi. Nxënësit, gjithashtu, respektojnë gjatë të shkruarit tiparet e tekstit, si dhe rregullat gjuhësore.

f) Përdorimi i drejtë i gjuhës

Që nxënësit të flasin dhe të shkruajnë në mënyrën e duhur, duhet të zotërojnë njohuri e të demonstrojnë shkathhtësi, vlera dhe qëndrime në lidhje me sistemin gjuhësor të gjuhës. Kështu, nxënësit: dallojnë pjesët e ndryshme të ligjëratës, kategoritë e tyre gramatikore dhe i përdorin në trajtën e duhur gjatë komunikimit; dallojnë llojet e ndryshme të fjalive dhe funksionet e fjalëve në fjali dhe i zbatojnë këto njohuri në komunikimin e përditshëm; përdorin gjuhën standarde dhe respektojnë diversitetin gjuhësor; dallojnë kuptimet e fjalëve dhe i përdorin për të pasuruar fjalorin e tyre.

6. Ndarja e orëve mësimore për secilën klasë

Në tabelën e mëposhtme është dhënë koha mësimore për gjuhën e huaj si lëndë e detyruar në arsimin e mesëm të lartë.

Orët mësimore

36 javë x 3 orë = 108 orë vjetore

Programi i gjuhës së huaj përcakton raportin: Komunikim, Formim kulturor dhe Formim gjuhësor. Kjo krijon mundësi për formimin e aftësive dhe shprehive afatgjata tek nxënësit.

Gjatë shtjellimit linear të lëndës në tekst (në kapituj e njësi mësimore) objektivat sipas kompetencave të përshkruara më lart ndërthuren me njëra-tjetrën dhe mund të zënë vend aty ku përdoruesi e sheh më të arsyeshme për t'i zbatuar. Konceptimi i kapitujve të tekstit dhe njësive mësimore është e drejtë dhe detyrë e autorit të tekstit dhe e mësuesit. E rëndësishme është në këtë rast që zbatuesit e programit të jenë të vëmendshëm në realizimin cilësor të të gjitha objektivave të përcaktuara në këtë program.

Shkalla e pestë	Komunikim dhe formim kulturor	Formim gjuhësor	Orë gjithsej
Klasa e dhjetë	70 orë	38 orë	108 orë

Mësuesi ka të drejtë të ndryshojë deri në masën 10% të orëve.

II. PËRMBAJTJA

Kompetenca: Të dëgjuarit

Përshkrimi i kompetencës

Nxënësi mund të kuptojë pikat themelore, kur përdoret një gjuhë e qartë dhe standarde dhe nëse bëhet fjalë për tema të njohura që kanë lidhje me punën, shkollën, kohën e lirë etj. Gjithashtu, nxënësi mund të kuptojë thelbin e një numri emisionesh në radio ose në televizion mbi aktualitetin ose mbi tema që i interesojnë personalisht ose nga ana profesionale.

Rezultatet e të nxënit për kompetencën e të dëgjuarit

Nxënësi:

- tregon se kupton pikat kryesore dhe mendimet e shprehura në pasazhe të përbëra nga materiale të njohura nga kontekste të ndryshme, duke përfshirë ngjarje të kaluara, të ditës apo të ardhme.

Njohuritë për realizimin e kompetencës

Aftësitë dhe shkathtësitë për realizimin e kompetencës

<p>Njohuritë për klasën e dhjetë</p> <ul style="list-style-type: none"> • Fjali të thjeshta mbi vendndodhjen. • Histori të thjeshta, ngjarje të thjeshta në kohën e tashme, të shkuar apo të ardhme. • Pjesë të incizuara, me kusht që folësi të jetë i qartë dhe të flasë me ritëm të ngadaltë. • Përshkrimi i një personi ose i një sendi. • Veprime matematikore, mbledhje, zbritje etj. • Kuptimi i mesazheve në ambiente të ndryshme publike, si: aeroport, supermarket, stacion treni etj. • Tekste të hartuara kryesisht me një gjuhë të përditshme që lidhen me punën e nxënësit. • Kuptimi i përshkrimit të ngjarjeve, shprehja e ndjenjave dhe e urimeve në letra personale. 	<p>Të dëgjuarit</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • kupton thelbin e asaj që thuhet në tema të njohura, si: puna, shkolla, argëtimet; • ndjek filma, nëse historia mbështetet tërësisht në veprime; • kupton mesazhe radiofonike ose televizive mbi tema të njohura si: shkolla, familja, argëtimet, shoqëria etj.; • ndjek një bisedë telefonike që trajton ngjarje të përditshme; • kupton reklama që i interesojnë, p.sh., reklamën e një kompjuteri, një celulari, një parfumi etj.; • kupton një guidë turistikenëse flitet qartë; • ndjek emisione televizive rreth temave që i interesojnë, si: dokumentarë mbi jetën e kafshëve, mjedisin etj.
---	---

Vlerat dhe qëndrimet për realizimin e kompetencës

Nxënësi:

- shfaq sjellje të përshtatshme gjatë të dëgjuarit si p.sh.: ndjek me vëmendje tekstin që dëgjon; nuk e ndërpret tjetrin, kur është duke folur; e sheh në sy personin gjatë kohës që flet; shpreh pëlqim dhe interes ose keqardhje ndaj asaj që dëgjon.

Kompetenca: Të folurit**Përshkrimi i kompetencës**

Nxënësi zotëron një gamë shumë të gjerë të gjuhës për të përshkruar situata të paparashikuara, shpjegon pikën kryesore të një problemi ose të një ideje me mjaft saktësi dhe shpreh mendimin e tij mbi subjekte abstrakte apo kulturore të tilla si: muzika dhe kinemaja. Ai mund të fillojë, të vazhdojë dhe të përfundojë një bisedë të thjeshtë, kokë më kokë, rreth temave të njohura ose temave të interesit personal.

Rezultatet e të nxënit për kompetencën e të folurit

Nxënësi:

- mund të marrë pjesë, pa u përgatitur, në një bisedë rreth temave të njohura;
- mund të komunikojë me një farë sigurie mbi tema të njohura, të zakonshme ose që nuk janë të lidhura me interesat e tij dhe fushën e tij profesionale;
- mund të përmbledhë dhe të ketë fjalën e fundit në një bisedë, duke lehtësuar kështu përqendrimin tek tema;
- mund të shprehë mendimin e tij mbi një temë abstrakte ose kulturore, si: film, muzikë, libër etj.

Njohuritë për realizimin e kompetencës

Aftësitë dhe shkathhtësitë për realizimin e kompetencës

- Jeta e përditshme
- Familja, rregullat e përgjegjësitë
- Bota përreth, fqinjët
- Çështje të ruajtjes së ambientit, ndotja, ngrohja globale, ndryshimet klimaterike
- Bota e komunikimit
- Artet
- Prezantimi dhe shoqërimi
- Shprehja e inkurajimit (*shumë mirë, të lumtë...*)
- Shprehja e preferencave (*më pëlqen... urrej...*)
- Paraqitja e një kërkesë ose e një oferte, (*... a mund, mundem...*)
- Këshillimi rreth diçkaje
- Aprovimi ose mosaprovimi, refuzimi... (*jam dakord, e ke gabim...*)
- Kërkim informacioni
- Diskutim i një plani udhëtimi
- Krahasimi i ndryshimeve
- Shprehja e një qëllimi
- Dhënia e arsyeve të ndryshme për një veprim
- Kërkesë për sqarime të mëtejshme
- Shprehje e sugjerimeve (*mendoj, po sikur...*)

Të folurit

Të folurit bashkëveprues

Nxënësi:

- shpreh ndjenja si habi, gëzim, trishtim, kureshtje etj., në situata të ndryshme;
- thotë me mirësjellje atë që mendon për diçka dhe nëse është dakord apo jo;
- ndërpret me mirësjellje bashkëfolësin, kur nuk është dakord ose i kërkon të përsërisë diçka që nuk e ka kuptuar si p.sh., mësuesin në mësim;
- interviston dikë mbi një temë të njohur, nëse pyetjet i ka përgatitur më parë;
- diskuton për një film, libër, këngë etj., si dhe shpreh dhe argumenton opinionin e vet.

Të folurit në vazhdimësi

Nxënësi:

- tregon një ngjarje që ka ndodhur dhe përshkruan ndjenjat e tij;
- tregon një ngjarje duke ruajtur kronologjinë;
- tregon ngjarjen e një libri që ka lexuar ose të një filmi që ka parë dhe tregon nëse i pëlqeu apo jo;
- paraqet një projekt (p.sh., ku do t'i kalojë pushimet, fundjavën

<ul style="list-style-type: none"> • Lajmërim e paralajmërim (<i>sigurohu, bëhu gati...</i>), • Dhënie e një porosie ose një sugjerimi • Preferencat për profesionin, modën, artet, sportin etj. 	<ul style="list-style-type: none"> • etj.); • tregon një film me fraza të thjeshta, p.sh., përmbledh ngjarjet kryesore në rrjedhën e tyre.
Vlerat dhe qëndrimet për realizimin e kompetencës	
Nxënësi:	
<ul style="list-style-type: none"> • përzgjedh fjalorin e duhur gjatë të folurit (nuk fyen të tjerët, përdor fjalët dhe shprehjet e mirësjelljes). 	

Kompetenca: Të lexuarit

Përshkrimi i kompetencës	
Nxënësi mund të kuptojë tekste të hartuara kryesisht në një gjuhë standarde që lidhen me punën e tij. Ai mund të kuptojë përshkrimin e ngjarjeve, shprehjen e ndjenjave dhe të urimeve në letra personale.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencën e të lexuarit	
Nxënësi:	
<ul style="list-style-type: none"> • mund të kuptojë thelbin e një tregimi të shkurtër, të strukturuar qartë; • mund të gjejë një informacion të caktuar në një tekst të gjatë (letër, tregim, artikull etj.), p.sh., vendin ku ndodh ngjarja, kohën, personazhet etj.; • mund të kuptojë detaje të përdorimit të një aparati të përditshëm, si kompjuter, MP3 I-pod, playstation; • mund të ritregojë ngjarjen në mënyrë koherente. 	
Njohuritë, aftësitë, shkathtësitë dhe qëndrimet për realizimin e kompetencës	
Njohuritë	Aftësitë dhe shkathtësitë
Njohuritë për klasën e dhjetë	Nxënësi:
<ul style="list-style-type: none"> • Dallimi i të dhënave personale, emër, 	<ul style="list-style-type: none"> • lexon tekste që përmbajnë fjalë dhe fraza me fjalor të njohur nga fondi bazë i gjuhës së huaj;

<p>adresë, ditëlindje, në një formular ose pyetësor</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kuptimi i një mesazhi, një ftese apo kartoline • Kuptimi i të dhënave kryesore në një menu, njoftim, orar, një faqe interneti etj. • Jeta e përditshme • Jeta e nxënësit, ndjenja, opinione, ide, moda, sporti • Shoqëria dhe miqësia • Udhëtimet • Profesionet • Bota rreth nesh, ambienti • Kuptimi i mënyrës së përdorimit (udhëzues) të një aparati të thjeshtë, si aparat fotografik, magnetofon etj. • Të ushqyerit dhe shëndeti, • Kuptimi i pikave kryesore në një tregim me temë familjare ose shoqërore 	<ul style="list-style-type: none"> • kupton një mesazh të thjeshtë, si: sms, e-mail etj.; • dallon të dhëna personale në një pyetësor; • identifikon mesazhe, komente të thjeshta mbi detyrat dhe punën e bërë; • lexon dhe kupton tekste të thjeshta me gjuhë jo shumë të ngarkuar; • dallon informacionin bazë dhe disa detaje në një tregim që trajton temë të njohur me fjalor përgjithësisht të trajtuar më parë; • identifikon mesazhin kyç në një njoftim ose faqe interneti; • identifikon shkaqet dhe arsyet e veprimeve dhe ndjenjave të personazheve realë apo letrar në një tekst gjuhësor.
<p>Vlerat dhe qëndrimet për realizimin e kompetencës</p>	

Nxënësi:

- lexon me interes, emocion, dëshirë dhe me ndjenjë.

Kompetenca: Të shkruarit

Përshkrimi i kompetencës

Nxënësi mund të shkruajë një tekst të thjeshtë dhe koherent mbi tema të njohura ose që i interesojnë personalisht. Ai mund të shkruajë letra personale duke përshkruar me hollësi përvoja, ndjenja dhe ngjarje.

Rezultatet e të nxënit për kompetencën e të shkruarit

Nxënësi:

- shkruan me detaje letra personale për të përshkruar eksperiencë, ndjenja dhe ngjarje;
- përshkruan pritshmëri, ambicie etj.;
- përshkruan përmbajtjen e një libri dhe qëndrimet e tij;
- shkruan një letër personale për të dhënë të reja, si dhe shpreh mendimin e tij mbi një temë abstrakte apo ose kulturore, si film, muzikë etj.

Njohuritë, aftësitë, shkathtësitë dhe qëndrimet për realizimin e kompetencës

Njohuritë

Aftësitë dhe shkathtësitë

<ul style="list-style-type: none"> • Shkrimi i një teksti koherent, të thjeshtë duke përdorur formula mirësjelljeje • Përshkrimi në një letër personale i familjes, vendit ku banon, kohës dhe me se merret • Përshkrimi i shtëpisë, punët shtëpiake dhe mobilimi • Përshkrimi i artikujve ushqimorë, i një recete kuzhine, shijeve, preferencave etj. • Përshkrimi i një personi duke dhënë detaje për veshjen, karakterin etj. • Përshkrimi i ngjarjeve në të shkuarën • Jeta e përditshme, rutinë, aktivitete, blerje, festime të ndryshme, ditëlindje etj. • Dieta dhe shëndeti • Rregullat në familje • Bota rreth nesh • Bota e komunikimit • Ambienti, ndotja, trafiku etj. 	<p>Nxënësi me një fjalor më të pasur:</p> <ul style="list-style-type: none"> • harton një C. V. (curriculum vitae) duke iu përgjigjur pyetjeve të një pyetësi, p.sh., përmbledh të dhënat personale; • përshkruan gjendjen e tanishme si p.sh., shkollën ku studion, klasën etj.; • përshkruan përvojat e kaluara; • përshkruan një ngjarje, një udhëtim real ose imagjinar si p.sh., përmbledh një qëndrim ose një udhëtim jashtë shtetit; • përshkruan shokë, miq, të afërm, personazhe, objekte, sende e kafshë të dashura për të; • përshkruan thjesht atë që dëshiron të bëjë në një të ardhme të afërt ose të largët si: shkollën që dëshiron të ndjekë, profesionin që do të ushtrojë, shqetësimet etj.
<p>Vlerat dhe qëndrimet për realizimin e kompetencës</p>	
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • mban gjatë të shkruarit pozicionin e duhur të trupit, dorës, fletores ose fletës ku shkruan. 	

Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës

Përshkrimi i kompetencës Nxënësi komunikon me një korrektesë të mjaftueshme në disa kontekste familjare; ka një kontroll të mirë gramatikor, pavarësisht nga ndikimet e pastra të gjuhës amtare; disa gabime mund t'i bëjë, por kuptimi i përgjithshëm është i qartë.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencën e përdorimit të drejtë të gjuhës Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">• përshkruan vende të ndryshme;• përshkruan eksperiencë dhe ngjarje të kaluara;• përshkruan ndjenja, emocione, qëndrime, opinione.	
Njohuritë, aftësitë, shkathtësitë dhe qëndrimet për realizimin e kompetencave të lëndës	
Njohuritë <ul style="list-style-type: none">• Kohët e foljeve (përsëritje nga klasat e mëparshme).• Të gjitha kohët e thjeshta e të përbëra të foljeve të rregullta e të parregullta.• Kohët e foljeve në të dyja trajtat, veprorë e pësore.• Ligjërata e drejtë dhe e zhdrejtë.• Mënyra kushtore.• Përemrat lidhorë.• Fjalët lidhëse (sepse, megjithëse etj.).• Frazelogji të thjeshta foljore.• Përemrat e pacaktuar (asnjëri, tjetri etj.).	Aftësitë dhe shkathtësitë Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">• përdor kohët e foljeve të mësuara deri tani;• përdor në fjali foljet e rregullta e ato të parregullta, në kohët e thjeshta e të përbëra;• bën përshkrime të ndryshme duke përdorur foljet në të dyja trajtat, veprorë dhe pësore;• kthen fjalitë nga ligjërata e drejtë në të zhdrejtë dhe anasjelltas;• përdor lidhëzat më të rëndësishme për të treguar rendin kronologjik të ngjarjeve;• përdor mënyrën kushtore si formulë politese;• përdor në fjali dhe situata të caktuara foljet modale, ndajfoljet e mënyrës, sasisë, kohës, vendit etj.;• përdor në fjali mënyrën kushtore;

<ul style="list-style-type: none"> • Mbiemra me ndajfolje (<i>shumë i gjatë, tepër i dobët</i>). • Mënyra përcjellore, koha e kryer (kam dy orë duke studiuar). • Format pësore të foljeve. • Ligjërata e drejtë (kërkesa, urdhra, pohime). • Foljet modale: mundësi, nevojë, detyrim. • Frazelogji foljore të thjeshta, me kuptim letrar dhe idiomatik. 	<ul style="list-style-type: none"> • përdor në fjali foljet modale për të dhënë një këshillë, për të shprehur një nevojë, apo një detyrim; • përdor në fjali frazeologji foljore të thjeshta, me kuptim letrar dhe idiomatik.
<p>Vlerat dhe qëndrimet për realizimin e kompetencës</p>	
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • paraqet dhe komunikon me gjuhë të thjeshtë mendimet e tij; • demonstroi pavarësi në mendime dhe veprime; • demonstroi besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve; • respekton përpjekjet personale dhe ato në grup. 	

III. UDHËZIME METODOLOGJIKE

Metodat e mësimdhënies janë mjaft të rëndësishme për të realizuar një mësimdhënie efektive. Përdorimi i tyre do të shërbejë për zhvillimin gjuhësor të nxënësve.

Mësuesit duhet të përditësojnë çdo ditë njohuritë rreth metodave, teknikave dhe strategjive të mësimdhënies me qëllim që të zhvillojnë tek nxënësit dëshirën për dijen, virtytet njerëzore, ambicien për të qenë të suksesshëm dhe aktivë në jetën e përditshme. Metoda, strategji dhe teknika të tilla, si: *diskutim për njohuritë paraprake, diagramë piramidale, lexim i drejtuar, imagjinata e drejtuar, parashikim me terma paraprake, harta e konceptit, rrjeti i diskutimit, pyetje autorit, ditaret e të nxënësve, pyetja sjell pyetjen etj.*, shërbejnë si nxitje për nxënësit në

procesin e të nxënit dhe si garanci për rezultate të mira në procesin e të nxënit. Mësimdhënia e gjuhës së huaj duhet të karakterizohet nga kriteret e mëposhtme:

Mësimdhënie me në qendër nxënësin

Nxënësit do të jenë në qendër të procesit të mësimdhënies. Ky proces do të ndërtohet në varësi të nevojave, aftësive dhe interesave të nxënësve. Nxënësit e një klase janë të ndryshëm, për sa i përket mënyrës se si ata nxënë: individualisht, në grup, nën udhëheqjen e mësuesit, të pavarur, me anë të mjeteve konkrete etj. Përpos kësaj, lënda e gjuhëve të huaja kërkon që nxënësit të nxënë konceptet, të zotërojnë shprehjet dhe të zbatojnë njohuritë gjuhësore. Të dy këto kushte diktojnë nevojën për strategji të ndryshme të mësimdhënies, të cilat përshtaten me objektin e të nxënit dhe nevojat e nxënësve. Qëllimi i çdo strategjie të mësimdhënies është që çdo nxënës të mësojë dhe të zbatojë njohuritë gjuhësore në mënyrë efektive.

Të mësuarit bashkëveprues

Mësuesit do të sigurojnë një mjedis të pasur dhe nxitës për komunikim dhe ndërveprim mes nxënësve. Ata do të përdorin metoda, strategji dhe teknika që nxitin të mësuarit bashkëveprues. Nxënësit gjatë orëve të gjuhës së huaj shpesh do të nxitin të punojnë së bashku. Detyrat e përbashkëta do t'u sigurojnë nxënësve më shumë kohë për të folur dhe për të ndarë përvojat e tyre me njëri-tjetrin. Njëherazi, edhe shkalla e zotërimit të gjuhës rritet. Puna në grupe do të nxisë tolerancën ndaj mendimit të tjetrit, si dhe do të ndikojë në përdorimin e formave demokratike për të ndarë përgjegjësitë dhe punën.

Integrimi

Linjat e programit: të lexuarit, të shkruarit, të folurit, të dëgjuarit dhe njohuri rreth sistemit gjuhësor do të trajtohen në mënyrë të integruar që të sigurohen lidhje kuptimplota mes tyre. Asnjëherë nuk mund të bëhen veprimtari vetëm për njërin nga linjat e programit. Ato plotësojnë njëra-tjetrën dhe zhvillohen së bashku. Një lidhje e fortë ndërmjet këtyre linjave forcon cilësinë e të nxënit të nxënësve.

Procesi i rimarrjes së njohurive

Aftësitë, njohuritë rreth sistemit gjuhësor, llojet e ndryshme të teksteve do të zhvillohen duke u rishikuar dhe rishqyrtuar vit pas viti, por në një nivel më të lartë vështirësie. Kjo do t'u mundësojë nxënësve të përparojnë nga niveli bazë në nivele më të larta të përdorimit të gjuhës.

IV. UDHËZIME PËR VLERËSIMIN

Roli kryesor i vlerësimit është të përmirësojë të nxënit. Informacioni i siguruar nga vlerësimi i ndihmon mësuesit të kuptojnë anët e dobëta dhe anët e forta të nxënësve në përmbushjen e objektivave të programit për secilën klasë, si dhe u jep mundësi të përmirësojnë mësimdhënien dhe të bëjnë propozime për përmirësimin e programeve.

Në përzgjedhjen e praktikave të vlerësimit, përcaktimin e kohës së përshtatshme për vlerësim dhe përzgjedhjen e materialeve që do të vlerësohen duhet pasur parasysh:

- përcaktimi i qëllimit dhe strategjisë së vlerësimit;
- përzgjedhja e veprimtarive që mundësojnë demonstrimin e arritjes së objektivave;
- përdorimi i vlerësimit për të verifikuar çfarë dinë aktualisht nxënësit;
- besimi se të gjithë nxënësit mund t'i përmirësojnë arritjet.

Vlerësimi i nxënësve ndahet në tre tipa kryesorë:

Vlerësimi diagnostikues që zakonisht kryhet në fillim të vitit shkollor ose para zhvillimit të një grupi orësh, për të identifikuar njohuritë paraprake, interesat ose aftësitë që kanë nxënësit rreth asaj për të cilën po kryhet vlerësimi. Ky informacion përdoret për të orientuar praktikën e mësimdhënies së mësuesit dhe të nxënit e nxënësve në mënyrë që të përcaktohen teknikat korrigjuese. Vlerësimi diagnostikues mund të jetë i shkurtër, i shpejtë, joformal dhe mund të bëhet me gojë dhe me shkrim.

Vlerësimi formues është një proces që ndodh gjatë gjithë kohës në klasë dhe informon nxënësit dhe mësuesit mbi progresin e nxënësve. Të dhënat dhe informacioni i mbledhur nga vlerësimi formues përdoren për të përmirësuar proceset e mësimdhënies dhe të nxënit. Fokusi i vlerësimit formues nuk duhet të jetë vetëm vlerësimi me notë i nxënësit.

Vlerësimi përmbledhës kryhet më shpesh në fund të një grupi orësh, për të përcaktuar çfarë është mësuar mbas një periudhe kohe dhe shoqërohet me notë. Vlerësimet përmbledhëse përdoren jo vetëm për të informuar nxënësit e prindërit për progresin e nxënësve, por edhe për të përmirësuar praktikatat e mësimdhënies dhe të nxënësve.

Gjatë zbatimit të programit nxënësve duhet t'u jepet mundësia të punojnë edhe në grup, për kryerjen e detyrave, të cilat mund të zgjidhen me këtë metodë pune. Në këto raste mësuesi parashtron peshën e vlerësimit me notë të grupit, në tërësi dhe të secilit nxënësi, në veçanti.

Mësuesi nuk e ka të detyrueshëm vlerësimin me notë të nxënësve në çdo orë mësimi dhe të vendosë nota në regjistër për secilën prej tyre. Si rregull, nxënësit dhe mësuesit duhet të bashkëbisedojnë lirshëm si partnerë rreth përvetësimit të njohurive të fituara të orëve të kaluara dhe mirë kryerjes së detyrave jashtë klase.

Komponentët e vlerësimit janë vlerësim me gojë dhe vlerësim me shkrim. Vlerësimi me shkrim shërben për aftësimin e komunikimit me shkrim. Mësuesi e vlerëson nxënësin me notë për parashtrimet me gojë, në testimet periodike me shkrim dhe në punët me shkrim, të zhvilluara vetë ose në grup.

Mësuesi planifikon teste periodike me shkrim për blloqe të gjera orësh mësimi, të cilat i bashkojnë objektiva të ndërlidhur të nxënësve. Një formë e vlerësimit me shkrim nga nxënësit janë edhe testimet semestrare dhe përfundimtare, të cilat nuk janë domosdoshmërisht të detyrueshme. Vlerësimi i punëve me shkrim është një mjet shumë i rëndësishëm i njohjes së aftësive gjuhësore të nxënësve. Njohja e këtij niveli, tashmë, nuk mund të bëhet vetëm me rrugët praktike e tradicionalisht të njohura, si: qortimet nga mësuesi. Praktikatat e reja sot orientojnë vendosjen e kriterëve dhe të standardeve të përshtatshme dhe të arritshme nga nxënësit. Kështu, duhen kërkuar forma të larmishme vlerësimi, të cilat të pasqyrojnë nivelin real të arritjeve të nxënësve për marrjen e masave për përmirësimin e tij. Mësuesi duhet ta ndjekë gjithë procesin e të shkruarit që nga planifikimi dhe deri tek rishikimi dhe redaktimi. Shënimet e mësuesit janë shumë të rëndësishme për vlerësimin e punëve me shkrim të nxënësve: ato duhet të jenë të tilla që t'i motivojnë ata. Vlerësimi që nxënësit mund t'i bëjnë njëri-tjetrit, është një tjetër formë e rëndësishme që ndihmon mbarëvajtjen e punës në këtë drejtim.

Portofoli i nxënësit, si një mundësi vlerësimi e vetëvlerësimi, është një koleksion i punimeve të tij përgjatë vitit shkollor. Ai mund të përmbajë punë me shkrim, detyra tematike, projekte lëndore e ndërlëndore etj. Përzgjedhjet për portofolin bëhen nga nxënësi, ndërsa mësuesi rekomandon.

Pjesë e vlerësimit është edhe informimi i nxënësve dhe prindërve për rezultatet e vlerësimit. Informacioni është përshkrues ose me notë. Detaje që kanë lidhje me vlerësimin gjenden në dokumente zyrtare të posaçme për këtë.